



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2025

Shtojca 13.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Data 18/12/2025.

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE)



ose

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) X

“Colombo LTD” Shpk, me Nuis M31420052T, me adrese Njesia Bashkiake nr. 9, Rruga “Mahmut Fortuzi”, Kati 3, Apartamenti 37, Tirane & “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” Shpk, me Nuis K82230002K, me adrese Rruga Tepelene-Progonat, Vendndodhja “Skaranë”, ngastra nr. 80 d, Kod kadastral Gj 3400080d rl, zk 1149, Tepelene, Gjirokaster, perfaqesuar nga OE “Colombo LTD” Shpk.

-OE “Colombo LTD” Shpk, me pjesemarrje prej 78 %

-OE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” Shpk, me pjesemarrje prej 22 %

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO **X**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO **X**

Tipi i Kontratës: Pune.

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur.

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: REF-64195-10-09-2025.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Ndertimi i varrezave te Qytetit te Lezhes, ne fshatin Merqi, Njesia Andministrative Kallmet, Bashkia Lezhe, LOTI 1”.

Kohëzgjatja e kontratës: 6 Muaj nga data e nenshkrimit te kontrates.

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 02/12/2025.

¹Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr. 78, datë 9 Dhjetor 2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik “BE - IS SH.P.K” Shpk, me Nuis K71412003A dhe me oferte ekonomike 33,760,125 (tridhjetë e tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e pesë) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

- 2- Operatori Ekonomik “BONUS Sh.p.k” Shpk, me Nuis K72412009E dhe me oferte ekonomike 29,519,658 (nëzet e nente milion e pesëqind e nentëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tete) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

- 3- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Colombo LTD” Shpk, me Nuis M31420052T & “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” Shpk, me Nuis K82230002K dhe me oferte ekonomike 33,861,555 (tridhjetë e tre milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) Lek pa Tvsh,
OE “Colombo LTD” Shpk, me pjesëmarrje prej 78 %
OE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” Shpk, me pjesëmarrje prej 22 %

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

OE/BOE me nënkontraktor

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

PO ☐ JO X

- 4- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “KEGLI-DURI” Shpk, me Nuis K94016202U & “LIS KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K66613407H dhe me oferte ekonomike 31,977,330 (tridhjetë e një milion e nentëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tridhjetë) Lek pa Tvsh,

OE “KEGLI-DURI” Shpk, me pjesëmarrje prej 80.1 %,

OE “LIS KONSTRUKSION” Shpk, me pjesëmarrje prej 19.9 %,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

- 5- Operatori Ekonomik “NIKA” Shpk, me Nuis J76705047U dhe me oferte ekonomike 34,842,675 (tridhjetë e katër milion e tetëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

- 6- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” Shpk, me Nuis J62904264O & “BLERIMI” Shpk, me Nuis J62903384G & “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” Shpk, me Nuis K81314023A dhe me oferte ekonomike 30,107,619.29 (tridhjetë milion e njëqind e shtatë mijë e gjashtëqind e nentëmbëdhjetë pike njëzet e nente) Lek pa Tvsh,

OE “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” Shpk, me pjesëmarrje prej 58.471 %,

OE “BLERIMI” Shpk, me pjesëmarrje prej 39.702 %,

OE “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” Shpk, me pjesëmarrje prej 1.827 %,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “BE - IS SH.P.K” Shpk, me Nuis K71412003A,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik rezulton se:

Nuk potëson pikën 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.7 të kriterëve të veçanta për kualifikim të Dokumenteve Standarte të Tenderit, pasi një pjesë e stafit teknik, stafit mbështetës dhe mjeteve të deklaruara nga Operatori Ekonomik **“BE - IS SH.P.K”**, rezultojnë të angazhuara në procedurën me objekt **“Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale në administrim të Bashkisë Lezhë”**, për të cilin ky OE ka lidhur kontratë pune me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Lezhë dhe aktualisht po angazhohen në kryerjen e punimeve në këtë objekt.

Sa me sipër, formulari i vetedeklarimit i paraqitur nga Operatori Ekonomik **“BE - IS SH.P.K”**, nuk pasqyron të dhënat reale të këtij subjekti lidhur me plotësimin e kriterëve 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.7 të Dokumentave Standarte të Tenderit dhe për rrjedhojë nuk përmbush kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 **“Për prokurimin publik”**, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nën 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 **“Për prokurimin publik”**, ku parashikohet: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh**

me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e **Operatori Ekonomik “BE - IS SH.P.K” Shpk, me Nuis K71412003A**, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “BE - IS SH.P.K” Shpk, me Nuis K71412003A, skualifikohet.

II-Operatori Ekonomik “BONUS Sh.p.k” Shpk, me Nuis K72412009E,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.5 të DST-se, ku parashikohet se: “Krahas stafit teknik Operoret Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

- Teknik ndertimi	2 (dy)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Gjeometer/Topograf	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Murator	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Pllakashtrues	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Betonues	1 (nje)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Karpentier	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Perpunues Guri	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Punonjes për punime në Rruge dhe Asfaltim	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Saldator	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Shofer	3 (tre)	Leje Drejtimi
- Manovrator	3 (tre)	Deshmi e Aftësisë Profesionale (DAP)

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesipër: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Deshmi të Aftësisë Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mesipërme si dhe stafi i mesipërme të figurojë në listepagesat e shoqërisë për periudhën Qershor 2025 – Gusht 2025.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) që nuk është leshuar sipas legjisllacionit përkatës të arsimimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të metejshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

Për profesionet si më sipër, operatori ekonomik duhet të plotësojë tabelën si më poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesis ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certifikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
.....					

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se dhe tabelës së mesiperme, të cilat duhet të dorëzohet në fazën e ofertimit në SPE. Ndërsa dokumentacioni provues i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

KVO verën se bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla dhe për të përmbushur këto kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetedeklarojnë në formularin permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se, të dhenat e stafit mbështetës që disponon sipas përcaktimeve të pikës 2.3.5 të DST-se duke plotësuar edhe tabelën në lidhje me profesionet.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, vërehet se operatori ekonomik në deklaratën për stafin për 2 (dy) punonjës “**Perpunues Guri**” dhe 2 (dy) “**Saldator**”, ka deklaruar se disponon deshmë profesionale për “**Perpunues Guri**” dhe “**Saldator**”, të lëshuar nga subjekti “Organizem Certifikimi HVAT”, me Nuis L71907002G, i cili ky i fundit nuk është i pajisur me license për formim profesional për ofrimin e kurseve dhe certifikimin e punonjësve të fushave “**Perpunues Guri dhe Saldator**” dhe për rrjedhojë nuk mund të trajnojë dhe certifikojë punonjës të kerkuar në DST.

Nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-se www.qkb.gov.al rezulton se subjekti “Organizem Certifikimi HVAT”, me Nuis L71907002G nuk disponon asnjë license për formim profesional për ofrimin e kurseve dhe certifikimin e punonjësve.

KVO thekson se ky subjekt nuk ka as në objektin e veprimtarisë certifikimin e punonjësve të fushave “**Perpunues Guri dhe Saldator**”, pasi nga verifikimi në faqen www.qkb.gov.al rezulton se ky subjekt në objektin e aktivitetit ka deklaruar “*Trup që operon në fushën e Çertifikimit të personelit elektrik sipas standardit SSH ISO 17024, mbi shkallën e rrezikut gjatë punës me rrymen elektrike, instalatoreve të N/ST dhe linjave të tensionit të lartë (TL),, elektricistëve që operojnë në rezidenca banimi dhe industriale, si dhe trupe inspektuese pale e trette në përputhje me kërkesat e Standartit S SH EN 17020: 2012, në fushat: - Inspektimi i linjave elektrike të tensionit të lartë (TL) dhe tensionit të ulët (TU) - Inspektimi i N/Stacioneve elektrike - Inspektimi i kabinave elektrike*

- Inspektimi i linjave elektrike kablllore TL dhe TU - Inspektim te linjave elektrike ne banesa, objekte publike dhe industriale - Inspektim te rrufepritesave - Inspektim te rrjetit te tokezimit dhe matje te rezistences se tokezimit - Inspektim dhe matje te fushes elektromagnetike ne ambiente dhe objekte me prezence te TL - Inspektim i relese diferenciale”.

KVO thekson se nga analizimi i kriterit 2.3.5 verehet se nder te tjera eshte sqaruar ne menyre te vecante kerkesa qe stafi mbeshtetes te jete i certifikuar sipas legjislacionit te arsimit profesional konkretisht si me poshte vijon:

“V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta....”.

KVO mban ne konsiderate se bazuar ne pikat 5 dhe 6, të Nenit 20, të Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 5 Kreu II , VKM Nr.538, datë 26.05.2009 "Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qëndrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, të pikës 9 të Udhëzimit të Ministrit, nr.1457, datë 28.07.2009 “Për procedurën e shqyrtimit të kërkesave për licensim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional”, i ndryshuar, subjektet qe plotesojne kriteret per ofrimin e kurseve te formimit profesional duhet te paraqesin kerkese per licensim per llojin e formimit profesional dhe pas miratimit te kerkeses dhe publikimit ne qkb.gov.al mund te vijojne me trajnimin dhe certifikimin e qytetareve qe shprehin interes per kete sherbim.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave rithekson bindjen e tij se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i plotesimit te kriterëve te vecanta te paraqitura ne DST, per tu permbushur njesoj nga te gjithe Operatorët Ekonomik pjesemarres është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në ligjmerine dhe efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si **lex specialis mbi lëndën.**

Theksojme se ushtrimi i aktivitetit te formimit profesional pa u pajisur paraprakisht me licensen perkatese eshte ne kundërshtim me percaktimet ligjore dhe mund te sjelle pasoja te qytetaret qe kerkojne te perfitojne nga formimet profesionale pasi subjektet qe nuk jane pajisur me licensen per formim profesional nuk i jane nenshtruar kontrollit te institucioneve shteterore mbi kapacitetin per ofrimin e formimit profesional.

Sa me siper nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE dhe ne web qkb.gov.al, rezulton se subjekti “Organizem Certifikimi HVAT”, me Nuis L71907002G, nuk eshte i pajisur me license per formim profesional per ofrimin e kurseve dhe certifikimin e punonjesve ne fushen “**Perpunues Guri**” dhe “**Saldator**” dhe per rrjedhoje operatori ekonomik ofertues nuk disponon ne stafin mbeshtetes 2 (dy) “**Perpunues Guri**” dhe 2 (dy) “**Saldator**”, te pajisur me deshmi profesionale te leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional duke mospermbushur kete kriter.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.10 te DST-se ku parashikohet se: “Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:

2.3.10/1 Gabion:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/2 Per Hekur:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga analizimi i Dokumentave standarte të tenderit vërehet se për vendosjen e këtij kriteri Autoriteti Kontraktor është bazuar në zërat e preventivit të punimeve që do të realizohen dhe rendesise të vecante të objektit të prokurimit duke vlerësuar si të nevojshme që mallrat që do të perdoren në realizimin e punimeve të furnizohen nga prodhues apo distributor të autorizuar, kjo në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Sa analizuam me siper dhe pas shqyrtimit të kriterit dhe qëllimit të vendosjes së tij nga ana e Autoritetit Kontraktor, KVO vëren se për përmbushjen e këtij kriteri OE-te në rast se ***nuk janë prodhues*** duhet të paraqesin për ***“Gabion” dhe “Hekurin”, kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar.***

Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatori ekonomik ka paraqitur në SPE:

- Për ***“Gabion” dhe “Hekurin”***, kontrate furnizimi lidhur midis OE "BONUS" SH.P.K dhe subjektit "Sokol Daku" P/F, i cili nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendres Kombëtare të Biznesit www.qkb.gov.al nuk rezulton të jetë prodhues apo të jetë paraqitur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike ndonjë dokument që provon lidhjen midis subjektit "Sokol Daku" P/F dhe ndonjë prodhuesi të gabionit dhe hekurit.

KVO thekson se nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se midis OE "BONUS" SH.P.K dhe subjektit "Sokol Daku" P/F, në të cilën ndër të tjera citohet se ***"FURNIZUESI" deklaron se është distributor për Gabion dhe Hekur"*** por nga verifikimi në SPE rezulton se nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që provon se ky i fundit ka të lidhur ndonjë marrëveshje si distributor me ndonjë prodhues.

KVO vëren se bashkëngjitur marrëveshjes së lidhur midis OE "BONUS" SH.P.K dhe subjektit "Sokol Daku" P/F është paraqitur një dokument i perkthyer me titull "CERTIFIKATË TESTIMI

MULLIRI”, por ne asnje pjese te ketij dokumenti nuk eshte i shkruajtur emri i subjektit "Sokol Daku" P/F. Per me teper ky dokument nuk i referohet ndonje marreveshje distributori.

Per sa parashturam me lart, sjellim ne vemendje se edhe **Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin Nr. 825/2021**, gjykon se per te permbushur qellimin e vendosjes se kriterit duhet te parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese te cilat vertetojne lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu **KPP** ka mbajtur te njejtin qendrim edhe ne **vendimin Nr. 604/2019**, ne te cilin thekson se : - **“KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, ”CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”, “CYCLO” dhe “CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”**

- **“KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi”.**

Sa me siper duke qene se furnizuesi i pretenduar nga Operatori Ekonomik per **gabion dhe hekur** nuk disponon dhe nuk rezulton ne Qendren Kombetare te Licensimit te jete i paisur me leje mjedisi si prodhues si dhe duke qene se nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër qe provon lidhjen midis tij dhe ndonje prodhuesi ky kriter konsiderohet i permbushur.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave rithekson bindjen e tij se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i plotesimit te kriterëve te vecanta te paraqitura ne DST, per tu permbushur njesoj nga te gjithe Operatoret Ekonomik pjesemarrës është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në ligjmerine dhe efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbështetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për

të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “**BONUS Sh.p.k**” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “BONUS Sh.p.k” Shpk, me Nuis K72412009E, skualifikohet.

III- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “KEGLI-DURI” Shpk, me Nuis K94016202U & “LIS KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K66613407H,

OE “KEGLI-DURI” Shpk, me pjesëmarrje prej 80.1 %,

OE “LIS KONSTRUKSION” Shpk, me pjesëmarrje prej 19.9 %,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se BOE ka dorezuar të gjithë dokumentacionin në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit.

Komisioni i vlerësimit të ofertave mbështetur në nenin 92, pika 3, ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, ku parashikohet shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Per sa me siper oferta e dorezuar nga BOE “KEGLI-DURI” Shpk, me Nuis K94016202U & “LIS KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K66613407H, kualifikohet.

Ne vijim, pas vleresimit te dokumentacionit ne SPE, ne daten 19/11/2025, Komisioni i Vleresimit te Ofertave u mblodh per vleresimin e dokumentacionit te BOE “KEGLI-DURI” Shpk, me Nuis K94016202U & “LIS KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K66613407H duke mbajtur ne konsiderate se:

- I. Komisioni i Vleresimit te Ofertave pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur ne SPE **ka vendosur te kualifikoje paraprakisht oferten e paraqitur nga BOE “KEGLI-DURI” Shpk & “LIS KONSTRUKSION” Shpk.**
- II. KVO ne daten 20.11.2025, pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur ne SPE, i kerkoi Bashkimit te Operatoreve Ekonomik “KEGLI-DURI” Shpk & “LIS KONSTRUKSION” Shpk, te klasifikuar i pari, te dorezoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2, të nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregulave te prokurimit publik” te ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike me date 27.10.2025.

.... **dhe** bazuar ne piken 1 dhe 5, te nenit 82, te Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

si dhe bazuar piken 1 dhe 6 te nenit 26, te VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

KVO verën se nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit konstatohet se me procesverbalin Nr. 01, datë 19/11/2025 për vleresimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit me objekt: “Ndertimi i varrezave të Qytetit të Lezhës, në fshatin Merqi, Njesia Administrative Kallmet, Bashkia Lezhë, LOTI 1”, Komisioni i Vleresimit të Ofertave ka kualifikuar Bashkimin e Operatoreve Ekonomik “KEGLI-DURI” Shpk, me Nuis K94016202U & “LIS KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K66613407H dhe me datën 20.11.2025, i ka kërkuar me anë të sistemit të Prokurimeve Elektronike dorëzimin e dokumentacionit fizik origjinal ose kopje

te njehesuar me origjinalin sipas parashikimit në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2, të nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2022 “Per miratimin e rregulave te prokurimit publik”, te ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike deri me datën 25.11.2025.

Komisioni i vleresimit te Ofertave, verifikoi ne zyren e protokoll-arkives, regjistrat e shkresave hyrese ne Institucion ku nga verifikimi rezulton se BOE “KEGLI-DURI” Shpk, me Nuis K94016202U & “LIS KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K66613407H nuk ka paraqitur asnje dokumentacion apo shkrese (kerkese) prane Bashkise Lezhe nga data e kerkeses se Autoritetit Kontraktor ne SPE deri ne daten 25.11.2025 dhe madje as deri ne daten e hartimit te ketij procesverbali.

Theksojme se ne nenin 26, pika 6, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2022 “Per miratimin e rregulave te prokurimit publik” te ndryshuar, parashikohet se *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur”.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave thekson se cdo operator ekonomik i cili kualifikohet paraprakisht pas vleresimit te dokumentacionit ne SPE, ka detyrimin ligjor te paraqitjes fizikisht prane Autoritetit Kontraktor te gjithe dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike ne perputhje me nenin 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2022 “Per miratimin e rregulave te prokurimit publik”, te ndryshuar.

Per sa me lart, Komisioni i Vleresimit te Ofertave konstaton se BOE “KEGLI-DURI” Shpk, me Nuis K94016202U & “LIS KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K66613407H nuk ka paraqitur asnje dokumentacion fizik origjinal apo kopje te njehesuar me origjinalin duke mos permbushur asnje nga kriteret e parashikuara ne DST.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe

profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e BOE “KEGLI-DURI” Shpk & “LIS KONSTRUKSION” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, BOE “KEGLI-DURI” Shpk, me Nuis K94016202U & “LIS KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K66613407H, skualifikohet.

IV-Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” Shpk, me Nuis J62904264O & “BLERIMI” Shpk, me Nuis J62903384G & “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” Shpk, me Nuis K81314023A,

OE “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” Shpk, me pjesëmarrje prej 58.471 %,
 OE “BLERIMI” Shpk, me pjesëmarrje prej 39.702 %,
 OE “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” Shpk, me pjesëmarrje prej 1.827 %,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkimi i Operatori Ekonomik rezulton se:

Se pari, nuk plotëson kriterin 2.3.5 të DST-se ku parashikohet se: “Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

- Teknik ndertimi	2 (dy)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Gjeometer/Topograf	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Murator	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Pllakashtrues	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Betonues	1 (nje)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Karpentier	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Perpunues Guri	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Punonjes per punime ne Rruge dhe Asfaltim	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Saldator	2 (dy)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Shofer	3 (tre)	Leje Drejtimi
- Manovrator	3 (tre)	Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)

Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Deshmi te Aftesise Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Qershor 2025 – Gusht 2025.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesit ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certefikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
.....					

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe tabelës se mesiperme, te cila duhet te dorezohet ne fazen e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimimit.

KVO veren se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te

permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit mbeshtetes qe disponon sipas percaktimeve te pikes 2.3.5 te DST-se duke plotesuar edhe tabelen ne lidhje me profesionet.

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE, verehet se operatori ekonomik ne deklaraten per stafin per 2 (dy) punonjesit perpunues guri, ka deklaruar se disponon deshmi profesionale per **“Perpunues Guri”**, te leshuar nga subjekti “Fire Protection” Shpk, me Nuis L41628006Q, i cili ky i fundit nuk eshte i pajisur me license per formim profesional per ofrimin e kurseve dhe certifikimin e punonjesve te fushave **“Perpunues Guri”** dhe per rrjedhoje nuk mund te trajnoje dhe certifikojë punonjesit e kerkuar ne DST.

Nga analizimi i kriterit 2.3.5 verehet se nder te tjera eshte sqaruar ne menyre te vecante kerkesa qe stafi mbeshtetes te jete i certifikuar sipas legjislacionit te arsimit profesional konkretisht si me poshte vijon:

“V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta....”.

KVO mban ne konsiderate se bazuar ne pikat 5 dhe 6, të Nenit 20, të Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 5 Kreu II , VKM Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, të pikës 9 të Udhëzimit të Ministrit, nr.1457, datë 28.07.2009 “Për procedurën e shqyrtimit të kërkesave për licensim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional”, i ndryshuar, subjektet qe plotesojne kriteret per ofrimin e kurseve te formimit profesional duhet te paraqesin kerkese per licensim per llojin e formimit profesional dhe pas miratimit te kerkeses dhe publikimit ne qkb.gov.al mund te vijoje me trajnimin dhe certifikimin e qytetareve qe shprehin interes per kete sherbim.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave rithekson bindjen e tij se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i plotesimit te kriterave te vecanta te paraqitura ne DST, per tu permbushur njesoj nga te gjithe Operatoret Ekonomik pjesemarres është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në ligjmerine dhe efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si **lex specialis** mbi lëndën.

Theksojme se ushtrimi i aktivitetit te formimit profesional pa u pajisur paraprakisht me licensen perkatese eshte ne kundërshtim me percaktimet ligjore dhe mund te sjelle pasoja te qytetaret qe kerkojne te perfitojne nga formimet profesionale pasi subjektet qe nuk jane pajisur me licensen per formim profesional nuk i jane nenshtruar kontrollit te institucioneve shtetore mbi kapacitetin per ofrimin e formimit profesional.

Sa me siper nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE dhe ne web qkb.gov.al, rezulton se subjekti “Fire Protection” Shpk, nuk eshte i pajisur me license per formim profesional per ofrimin e kurseve

dhe certifikimin e punonjesve ne fushen “*Perpunues Guri*” dhe per rrjedhoje operatori ekonomik ofertues nuk disponon ne stafin mbeshtetes **2 (dy)** punonjes “*Perpunues Guri*”, te pajisur me deshmi profesionale te leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional duke mospermbushur kete kriter.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.10 te DST-se ku parashikohet se: “**Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:**

2.3.10/1 Gabion:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/2 Per Hekur:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga analizimi i Dokumentave standarte te tenderit verehet se per vendosjen e ketij kriteri Autoriteti Kontraktor eshte bazuar ne zerat e preventivit te punimeve qe do te realizohen dhe rendesise se vecante te objektit te prokurimit si dhe rendesine e zones ku do te kryhen punimet duke vleresuar si te nevojshme qe mallrat qe do te perdoren ne realizimin e punimeve te furnizohen nga prodhues apo distributor te autorizuar, kjo ne perputhje me kerkesat ligjore te parashikuara ne pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe ne nenin 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Sa analizuam me siper dhe pas shqyrtimit te kriterit dhe qellimit te vendosjes se tij nga ana e Autoritetit Kontraktor, KVO veren se per permbushjen e ketij kriteri OE-te ne rast se ***nuk jane prodhues*** duhet te paraqesin per “***Gabion*”, kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar.**

Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se ne lidhje me plotesimin e dokumentacionit per permbushjen e kriterit **2.3.10/1**, eshte paraqitur ne SPE nje dokument me emertim “Kontrate furnizim Gabion”, ku ne kete dokument paraqitet nje kontrate furnizimi lidhur midis OE “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” SH.A dhe subjektit “Grimer Gabion” SH.P.K, i cili nga verifikimi ne Qendren Kombetare te licensimit nuk rezulton te jete prodhues apo te jete paraqitur ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike ndonje dokument qe provon lidhjen midis subjektit “Grimer Gabion” SH.P.K dhe ndonje prodhuesi te gabionit.

Per me teper edhe nga nje verifikim ne faqen zyrtare te Qendres Kombetare te Biznesit www.qkb.gov.al, te ekstraktit se regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit mbi aktivitetin e subjektit “Grimer Gabion” SH.P.K, ky i fundit nuk rezulton te kete **vetedeklaruar** ne objektin e aktivitetit te tij prodhimin e **Rrjetes se telit Gabion**.

Ne vijim, Komisioni i Vleresimit te Ofertave duke pasur qellim kryerjen e nje vleresimi sa me objektiv dhe gjithë perfshires si dhe duke patur ne konsiderate se te gjithë prodhuesit ne Republiken e Shqiperise e kane detyrim ligjor paisjen me leje mjedisore nga Qendra Kombetare e Licensimit, beri nje kerkim ne faqen zyrtare te saj, ku rezultoi se subjekti “Grimer Gabion” SH.P.K nuk disponon leje mjedisi si prodhues per **rrjete teli gabion** apo te ndonje produkti tjetër te ngjashem me te.

Per sa parashturam me lart, sjellim ne vemendje se edhe **Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin Nr. 825/2021**, gjykon se per te permbushur qellimin e vendosjes se kriterit duhet te parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese te cilat vertetojne lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu **KPP** ka mbajtur te njejtin qendrim edhe ne **vendimin Nr. 604/2019**, ne te cilin thekson se : - **“KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, ”CHAMPION”, ”RAVENOL”, ”CASTROL”, ”MOTUOL”, ”CYCLO” dhe ”CHIMITEK, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”**

- **“KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi”.**

Sa me siper duke qene se furnizuesi i pretenduar nga Operatori Ekonomik per **rrjete teli gabion** nuk disponon dhe nuk rezulton ne Qendren Kombetare te Licensimit te jete i paisur me leje mjedisi si prodhues si dhe duke qene se nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër qe provon lidhjen midis tij dhe ndonje prodhuesi ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave rithekson bindjen e tij se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i plotesimit te kriterëve te vecanta te paraqitura ne DST, per tu permbushur njesoj nga te gjithë Operatoret Ekonomik pjesemarres është i një rëndësie thelbësore

e me ndikim të drejtpërdrejtë në ligjmerine dhe efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nën 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nën 92, pikë 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e BOE “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” Shpk, me Nuis J629042640 & “BLERIMI” Shpk, me Nuis J62903384G & “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” Shpk, me Nuis K81314023A, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, BOE “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” Shpk, me Nuis J629042640 & “BLERIMI” Shpk, me Nuis J62903384G & “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” Shpk, me Nuis K81314023A, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “Colombo LTD” Shpk, me Nuis M31420052T, me adresë Njesia Bashkiake nr. 9, Rruga “Mahmut Fortuzi”, Kati 3, Apartamenti 37, Tiranë & “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” Shpk, me Nuis K82230002K, me adresë Rruga Tepelene-Progonat, Vendndodhja “Skaranë”, ngastrat nr. 80 d, Kod kadastral Gj 3400080d rl, zk 1149, Tepelene, Gjirokastrë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 33,861,555 (tridhjetë e tre milion e teteqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) Lek pa Tvsh është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë zyres se protokollit të Bashkisë Lezhë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO X JO ☐

(Vendimi përfundimtar Nr.1862/2025, për shqyrtimin e ankesës të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI
Pjerin NDREU